

V E N D I M
Nr.107, datë 6.8.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 4.8.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.113 Akti që i përket:

KËRKUES:

- 1.PARTIA REPUBLIKANE E SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Spartak Ngjela.
2. MUSLIM MURRIZI, kandidat për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar nga Ferdinand Pone.
- 3.PARTIA DEMOKRATE E SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Sali Kelmendi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR i ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. ASLLAN HAXHIU, kandidat për deputet i Partisë Socialiste.
3. PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE, në mungesë.
4. PARTIA AGRARE, në mungesë.
5. PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, në mungesë.
6. PARTIA SOCIALISTE, në mungesë.
7. PARTIA SOCIALDEMOKRATE, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i pavlefshëm i vendimeve nr.209 dhe nr.211 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të kandidatit për deputet dhe të listës shumemërore për zonën zgjedhore nr.60.

Kërkuesit të cilët kanë paraqitur kërkesa të veçanta, por që me vendim të ndërmjetëm të Gjykatës Kushtetuese janë bashkuar në një çështje të vetme, kanë parashtruar këto shkaqe kryesore për shfuqizimin e vendimeve të sipërcituara:

- I gjithë procesi zgjedhor në zonën nr.60 është shoqëruar me shkelje të shumta të ligjit, të cilat kanë ndikuar në nxjerrjen e një rezultati të manipuluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si për shpalljen e kandidatit të drejtpërdrejtë, ashtu edhe për listën shumemërore.
- Përsëritja e zgjedhjeve për proporcionalin në këtë zonë zgjedhore ka cenuar lirinë, barazinë dhe peshën e votës të sanksionuar në nenin 45/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- Zhvillimi i votimit për listën shumemërore është antikushtetues për faktin se neni 64/2 i Kushtetutës thekson se për llogaritjen e proporcionalit njihen vetëm votat e vlefshme të fituara nga partitë ose koalicionet në raundin e parë të zgjedhjeve.
- Është shkëlur neni 18 i Kushtetutës, për arsye se zhvillimi i votimit në zonën zgjedhore nr.60 për raundin e parë, në një datë tjetër, ka sjellë një diskriminim për të gjitha partitë e tjera të cilat u dëmtuan nga veprimet e paligjshme të Partisë Socialiste.

- Kryerja e zgjedhjeve për listën shumemërore në këtë zonë zgjedhore ka bërë që të ndryshohen rregullat e lojës, ndërkohë që loja ka përfunduar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuësve, të subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Pretendimet e kërkuësve për të argumentuar përpara Gjykatës Kushtetuese pavlefshmërinë e vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve grupohen në dy drejtime kryesore, të cilat sipas tyre lidhen me shkeljet gjatë procesit zgjedhor për shpalljen e kandidatit të drejtpërdrejtë, si dhe me paligjshmërinë dhe antikushtetutshmërinë e votimit për listën shumemërore të subjekteve politike.

Për të analizuar këto çështje në tërësinë e tyre, Gjykata Kushtetuese e çmon të domosdoshme të theksojë se pretendimet e kërkuësve për parregullsi apo shkelje të ligjit lidhur me procesin zgjedhor të zhvilluar në zonën zgjedhore nr.60, janë përsëritje e të njëjtave argumente dhe shkaqeve që ata kanë parashtruar në seancën gjyqësore të datës 26.6.2001. Edhe në këtë çështje, objekt shqyrtimi janë parashtruar të njëjtat shkelje ligjore, duke u bazuar mbi ato prova shkresore, dhe veçanërisht mbi procesverbalin e mbajtur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të cilat Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.102, datë 29.7.2001 ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar pabazueshmërinë e saj në ligj dhe në prova.

Në këto kushte, përdërisa kërkuësit nuk kanë paraqitur ndonjë shkak apo provë të re për të argumentuar pretendimin për pavlefshmëri të vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tej atyre që janë administruar në çështjen e gjykuar më parë, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkesa e tyre në këtë aspekt duhet rrëzuar.

Përsa i përket pretendimeve të tjera të kërkuësve me të cilat është bashkuar edhe Partia Demokratike dhe që kanë të bëjnë me paligjshmërinë apo antikushtetutshmërinë e zhvillimit të votimit në zonën nr.60 për listat shumemërore të subjekteve zgjedhore, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme që t'i analizojë dhe interpretojë ato në përputhje me ligjin dhe parimet kushtetuese.

Kërkuësit pretendojnë se përsëritja e zgjedhjeve pas datës 24.6.2001 për listën proporcionale në këtë zonë zgjedhore ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve në zonat e tjera, duke cenuar në këtë mënyrë lirinë dhe barazinë e votës.

E drejta e votës është një nga të drejtat themelore të shtetasve dhe, si të gjitha të drejtat e tjera, mbetet e padhunueshme. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 45 të saj ka sanksionuar të drejtën e çdo shtetasi për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, të drejtë të cilën ai e realizon nëpërmjet votës vetiake, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë.

E drejta e votës përbën një të drejtë të pakufizuar. Sipas konceptit kushtetues, nga ushtrimi i të drejtës së votës nuk mund të privohet askush, me përjashtim të shtetasve të deklaruar si të paaftë mendërisht me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Votat e të gjithë zgjedhësve kanë të njëjtën peshë dhe llogariten në të njëjtën mënyrë. Koncepti kushtetues i votës së barabartë i vendos të gjithë shtetasit në pozita të njëjta, me qëllim që gjithësecilit t'i krijohet mundësia për të votuar vetëm një herë. Gjithashtu, koncepti i barazisë së votës, i analizuar në kuptim të nenit 64 pika 1 të Kushtetutës, shprehet edhe në faktin e ndarjes së zonave njëemërore në numër të përafërt zgjedhësish.

Ndikimi që subjektet zgjedhore ushtrojnë mbi shtetasit gjatë periudhës së zgjedhjeve, nëpërmjet propagandës elektorale, nuk prek konceptin kushtetues të lirisë së votës. Të drejtën për të zgjedhur çdo zgjedhës e përcakton vetë me dëshirën e tij dhe pa asnjë detyrim. Ushtrimi i të drejtës së votës nga zgjedhësit është rezultat i bindjeve të tyre personale. Natyrisht që ndikimi mbi zgjedhësit për marrjen e votës edhe në rastet kur zgjedhjet bëhen në një kohë të mëvonshme, mund të jetë evident, por duke iu referuar sistemit tonë elektorale, i cili pranon raundet, ai nuk përbën problem, ashtu siç nuk përbën problem edhe në rastet e balotazhit.

Prandaj, nga të gjitha provat e administruara në seancë gjyqësore, Gjykata Kushtetuese krijon bindjen se zgjedhësit në zonën zgjedhore nr.60, gjatë procesit të votimit e kanë ushtruar lirisht të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe pretendimi i kërkuësit për cenim të lirisë dhe barazisë së votës apo

për peshën e veçantë të votës në këtë zonë, nuk përputhet me konceptet dhe parimet që Kushtetuta, por edhe doktrina kushtetuese ka sanksionuar për këtë të drejtë themelore. E në këtë aspekt, çdo veprim që mund të ndërmerrej nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për moszhvillimin e votimit për listat shumëmemërore të subjekteve në këtë zonë zgjedhore do të përbënte një shkelje kushtetuese ndaj të drejtës së shtetasve për të zgjedhur.

Pretendimi tjetër i kërkuësve lidhet me kuptimin e gabuar që, sipas tyre, i është bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve termit kushtetues "raund i parë i zgjedhjeve", i cili ka lejuar përsëritjen e votimit për listën e proporcionalit në këtë zonë zgjedhore pas datës 24.7.2001.

Argumentin kryesor për të mbështetur pretendimin e tyre kërkuësit e gjejnë tek kuptimi lingistik që fjala "round" ka në gjuhën angleze, e cila zërbërhet si "i plotë", "komplet", "i gjithë", "i pandarë", "që nga fillimi deri në fund", etj. Referimi në terminologjinë e gjuhës është mjaft i saktë, por interpretimi gjuhësor dhe ligjor i këtyre termave nuk shkon në favor të argumentit të kërkuësit. Përkundrazi, moskryerja e raundit të parë të zgjedhjeve në zonën nr.60 në datën 24.7.2001 dhe, sidomos, mospërsëritja e tyre në të ardhmen do t'i jepte raundit një tjetër kuptim, të ndryshëm nga kuptimi kushtetues i mësipërm, pasi raundi i parë i zgjedhjeve do të konsiderohej në këtë mënyrë "i paplotë", "i pakompletuar" dhe "i pakryer nga fillimi në fund". Kjo do të binte ndesh edhe me vetë konceptin që ka përcaktuar Kodi Zgjedhor, sipas të cilit votimi për listën shumëmemërore të subjekteve kryet vetëm në një raund, pra në raundin e parë, në dallim nga votimi për kandidatët, për të cilët mund të votohet me dy raunde.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që ndodhet në dosje, rezulton se raundi i parë i zgjedhjeve i zhvilluar në datën 24.7.2001 është ndërprerë në zonën zgjedhore nr.60, duke mbetur në këtë mënyrë i papërfunduar dhe në kuptim të dispozitave kushtetuese mbetet detyrimi për t'u realizuar në mënyrë të plotë.

Zhvillimi i raundit të parë në një datë tjetër nuk mund të konsiderohet si shkelje e nenit 64 të Kushtetutës. Edhe pse kjo dispozitë nuk e lidh zhvillimin e raundit të parë me një datë të caktuar, është e kuptueshme që, për arsye të përligjura, si në rastet e fatkeqësive natyrore, ashtu edhe në rastet e shpalles së pavlefshmërisë së zgjedhjeve nga organet e përcaktuara në nenin 113 të Kodit Zgjedhor, zgjedhjet në një ose disa zona mund të zhvillohen në raundin e parë në një datë tjetër.

Sipas nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë "numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie apo koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve".

Duke interpretuar këtë dispozitë kushtetuese, rëndësi marrin disa momente esenciale që përcaktojnë thelbin e vërtetë të saj. Kuptimi i dispozitës së sipërcituar lidhet me kryerjen e votimit në të gjithë vendin, si dhe me zhvillimin detyrimisht të raundit të parë të zgjedhjeve për të përcaktuar me saktësi numrin e deputetëve të Kuvendit, nga i cili nuk mund të përjashtohet asnjë zonë zgjedhore.

Neni 64 i Kushtetutës parashikon se territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në 100 zona zgjedhore për efekt të sistemit mazhoritar, duke lënë të kuptohet se ekziston një zonë e vetme për të gjithë vendin për përcaktimin e listës proporcionale. Çdo lloj ndarjeje, veçimi apo përjashtimi përfundimtar nga zgjedhjet që mund t'i bëhej territorit të Republikës së Shqipërisë apo pjesëve të veçanta të tij do të përbënte një cenim të koncepteve kushtetuese, që përcaktojnë llojin e sistemit elektorale, si dhe njëkohësisht një dhunim të së drejtës themelore të shtetasve për të votuar.

Nga ky këndvështrim i problemit, Gjykata Kushtetuese konkludon se nëse nuk do të kryhej votimi në zonën zgjedhore nr.60 për listën shumëmemërore të subjekteve politike, atëherë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë do të shkelej, zgjedhësit do të dhunoheshin në ushtrimin lirisht të të drejtës së votës dhe raundi i parë i zgjedhjeve nuk do të konsiderohej i përfunduar.

Kërkuësit pretendojnë se është shkelur neni 18 i Kushtetutës, sipas të cilit partitë politike janë vënë në një pozicion diskriminues në raport me të tjerat. Duke iu referuar nenit 18 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të analizojë kuptimin e vërtetë të kësaj dispozite, e cila nuk lidhet me diskriminimin e personave juridikë, ku përfshihen edhe partitë politike, por ajo ndalon diskriminimin që mund t'i bëhet individëve për shkak të gjinisë, racës, fesë, bindjeve politike, gjendjes ekonomike, arsimore ose përkatësisë prindërore.

Referimi që përdorin kërkuësit për të arsyetuar pretendimin e tyre për diskriminim të partive politike për arsye të zhvillimit të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.60 nuk është i drejtë. Përkundrazi referimi në këtë dispozitë kushtetuese shërben si një argument, i cili është në favor të të drejtës së shtetasve për të votuar. Moslejimi i zgjedhësve në zonën zgjedhore nr.60 për të votuar për listën

shumemërore të subjekteve politike, siç pretendon kërkuesi, jo vetëm që do t'u mohonte atyre të drejtën e votës, por njëkohësisht do t'i vinte në një pozitë të pabarabartë dhe diskriminuese në raport me zgjedhësit e zonave të tjera.

Kërkuesit e konsiderojnë zhvillimin e zgjedhjeve në zonën nr.60 si një ndryshim të rregullave të lojës në një kohë që loja ka përfunduar. Analogjia që përdorin kërkuesit për zgjidhjen e çështjes konkrete, duke iu referuar jurisprudencës ndërkombëtare, nuk është e saktë. Rezulton e provuar se deri në datën 8.7.2001, datë në të cilën u zhvilluan zgjedhjet në zonën zgjedhore nr.60, si për kandidatin për deputet, ashtu dhe për listën proporcionale të subjekteve politike, nuk janë ndryshuar rregullat e lojës, ndërkohë që loja vazhonte. Do të konsiderohej e gabuar nëse rregullat e lojës do të ndryshoheshin nga arbitri. Përkundrazi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që në datën 2.7.2001, me vendimet nr.15 dhe nr.16, të shpallë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.60, si dhe kryerjen e tyre në datën 8.7.2001. Ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili vendosi zhvillimin e zgjedhjeve për kandidatët për deputet dhe për listat shumemërore asnjë subjekt zgjedhor nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatë.

Në këto kushte, palët kanë pranuar të hynin në zgjedhjet e datës 8.7.2001 pa patur asnjë kontestim për këtë vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe as për rregullat e vendosura nga ai. Nëse subjektet e ndryshme zgjedhore përdorën taktikat zgjedhore sipas strategjisë së tyre politike, por brenda rregullave të ligjit, ky nuk është një problem që i përket për zgjidhje Gjykatës Kushtetuese.

Nisur nga të gjithë argumentat e sipërcituara, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga kërkuesit nuk është e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Zgjedhor dhe në prova e, për rrjedhojë, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës, në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe në nenin 113 e vijues të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa duhet të ishte pranuar për këto arsye:

1.Kuptimi i raundit të parë të zgjedhjeve përcaktohet qartë në nenin 64 të Kushtetutës dhe në dispozitat e Kodit Zgjedhor. Sipas nenit 64/2 të Kushtetutës, ndarja e deputetëve të proporcionalit përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve. Ndërsa në nenin 65/2 të Kushtetutës është caktuar afati i zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin, që është 60 deri 30 ditë para mbarimit të mandatit. Data 24 qershor 2001 përbënte afatin e fundit të zgjedhjeve për Kuvendin, sipas këtij përcaktimi kushtetues, prandaj raundi i parë duhej të ishte zhvilluar i plotë në të gjithë vendin. Caktimi i raundit të parë të zgjedhjeve për zonën nr.60 në një datë tjetër tej këtij afati përbën shkelje të Kushtetutës.

Në zbatim të këtyre detyrimeve kushtetuese, Kodi Zgjedhor ka caktuar rregulla më të plota e më të qarta, duke mos lënë asnjë ekuivok për kuptimin e raundit të parë të zgjedhjeve. Kështu, sipas nenit 4/2 të Kodit, raundi i parë i zgjedhjeve për Kuvendin zhvillohet 60 deri 30 ditë para mbarimit të mandatit të tij, ç'ka presupozon zhvillimin e menjëhershëm të tij në të gjithë vendin dhe nxjerrjen po të njëherëshme të rezultatit. Në dallim nga raundi i parë, Kodi Zgjedhor, në nenin 2 pika 18 jep edhe kuptimin e "raundin e dytë", që është zhvillimi i një votimi të dytë në njësi zgjedhore, për shkak se asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar të votave në datën e zgjedhjeve, sipas këtij Kodi. Se çfarë është "data e zgjedhjeve", kjo del qartë nga përmbajtja e nenit 2 pika 1, ku thuhet se "është data e votimit e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës dhe nuk përfshin datën kur mund të zhvillohet një raund i dytë votimi".

Siç shihet, këto përcaktime kushtetuese dhe ligjore lidhur me raundin e parë të zgjedhjeve, janë të tilla që nuk lejojnë kryerjen e votimeve të raundit të parë në data të ndryshme pasi të ketë dalë rezultati në zona të tjera apo të jetë caktuar e zhvilluar raundi i dytë (balotazhi). Raundi i parë i zgjedhjeve duhet konceptuar si një cikël i mbyllur, para se të zhvillohet raundi i dytë apo përsëritja e zgjedhjeve për pavlefshmëri. Për këtë rastin e fundit të parashikuar nga neni 113 i Kodit Zgjedhor, pavlefshmëria vendoset nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas konsultimeve me komisionin e zonës zgjedhore përkatëse, kërkesë ligjore kjo që në rastin konkret nuk është zbatuar.

2. Fakti që në zonën zgjedhore nr.60 zgjidhen 10 deputetë ose 1/4 e gjithë proporcionalit tregon qartë deformimin e sisemit zgjedhor, duke prekur edhe barazinë e votës në kuptimin e vlefshmërisë së saj. Kështu, siç thuhet në konkluzionet paraprake të Misionit Ndërkombëtar Vëzhgues të Zgjedhjeve: "Votuesit në Lushnjë ishin në një pozicion që mund të ushtronin një ndikim shumë më të madh se të tjerët në rezultatin e zgjedhjeve".

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke marrë kompetencat e komisionit të zonës zgjedhore për të nxjerrë vetë rezultatin e votimit, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi një kompetencë e tillë nuk parashikohet në asnjë dispozitë ligjore. Përkundrazi, në nenin 18 të Kodit Zgjedhor, i cili rregullon kompetencat e këtij organi, në pikën 4 thuhet se shpall me vendim rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në shkallë vendi, në bazë të rezultateve të shpallura nga komisioni i zonës zgjedhore. Ky përcaktim ligjor nuk lë shteg që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si organi më i lartë, të marrë kompetencat e organit më të ulët sipas parimeve të përgjithshme, aq më tepër që në marrjen e kësaj kompetence ka eliminuar një shkallë të procesit dhe të drejtën e ankimit për rezultatin përfundimtar, që do të nxirrte komisioni i zonës zgjedhore. Në zbatim të kompetencave ligjore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në rastin konkret, duhet të kishte vepruar në përputhje me kërkesat e pikës 8 të nenit 18 të Kodit Zgjedhor, që i jep të drejtë të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e komisionit të zonës zgjedhore deri në emërimin e anëtarëve të nevojshëm për plotësimin e kuorumit.

4. Ka shkelje ligjore dhe parregullsi të shumta edhe përsa i përket anës praktike të problemit. Sipas procesverbalit të mbajtur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për kontrollin e kutive të votimit, rezultojnë shkelje e mangësi të ndryshme deri në mosgjatjen në një pjesë të madhe të kutive të votimit, të tabelave të rezultateve. Ky fakt tregon për nxjerrjen e një rezultati joreal dhe të kontestueshëm. Precedenti i lejuar për nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për proporcionalin në zonën zgjedhore nr.60 është një veprim antikushtetues dhe i rrezikshëm, që vjen ndesh edhe me përmbajtjen e nenit 3 të Kushtetutës për mbrojtjen e pluralizmit dhe me dokumentin e Mbledhjes së Kopenhagenit të Konferencës mbi dimensionin njerëzor të KSBE-së të datës 29 qershor, ku pranohet pluralizmi si element thelbësor i shtetit demokratik dhe zhvillimi i zgjedhjeve të lira në kushte që të garantojnë efektivisht shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve në caktimin e përfaqësuesve të tyre.

ANËTAR
K.Peçi

MENDIM I PAKICËS

Kërkesa e kandidatit për deputet të subjektit "Bashkimi për Fitore" "zotit Muslim Murrizi për një proces të parregullt zgjedhor është e drejtë. Por, meqenëse në këtë kërkesë kërkuesi ka paraqitur të njëjtat pretendime dhe argumente që ka parashtruar edhe në kërkesën e tij të parë, e cila është shqyrtuar në seancën gjyqësore të datës 26.7.2001, i qëndroj mendimit tim të pakicës në vendimin

nr.102, datë 29.7.2001 të Gjykatës Kushtetuese, ku kam paraqitur argumentet ligjore dhe kushtetuese për pranimin e kërkesës.

Përsa i përket kërkesës së paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike për shfuqizimin e vendimit nr.211, datë 31.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me rezultatin përfundimtar për subjektet politike (proporcionali) për zonën zgjedhore nr.60, mendoj se është e drejtë dhe duhet pranuar.

Zhvillimi i zgjedhjeve për subjektet politike, pra për përfaqësimin proporcional, vjen në kundërshtim me nenin 64/2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: "Numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe/ose koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve". Pra sipas Kushtetutës, proporcionali zhvillohet në një raund të vetëm.

Mendoj se koncepti kushtetues i raundit të parë, që presupozon dhe një raund të vetëm, është i lidhur në radhë të parë me zhvillimin e zgjedhjeve për proporcionalin në një datë dhe në të njëjtën periudhë kohore në të gjithë vendin, d.m.th. më 24.6.2001 dhe në kohën që përcakton Kodi Zgjedhor.

Në nenin 2 të Kodit Zgjedhor jepet përkufizimi i raundit të dytë si një përjashtim për kandidatët, sepse vetë sistemi elektoral e ka parashikuar këtë rast. Ndërsa për raundin e parë nuk ka parashikim të veçantë, sepse e kundërta mund të sjellë pasoja që të dëmtojnë në thelb të drejtën e votës të çdo shtetasi dhe vetë sistemin elektroal të parashikuar në Kushtetutë.

Në rastin konkret, mendoj se duhet bërë një interpretim i nenit 64/2 të Kushtetutës mbi konceptin e raundit të parë dhe të vetëm në të gjithë Shqipërinë, lidhur me përfaqësimin proporcional.

Me vendimin nr.015, datë 2.7.2001, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur të pavlefshme zgjedhjet për Kuvendin në zonën zgjedhore nr.60 për arsye organizative të punës së komisionerëve.

Pra, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka patur një arsye të vërtetë për të mos zhvilluar zgjedhjet në këtë zonë dhe se arsyet organizative të punës nuk përbëjnë shkak, sipas përmbajtjes së nenit 113 të Kodit Zgjedhor, për të shpallur zgjedhjet e pavlefshme.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në këtë rast, për të respektuar konceptin kushtetues të një raundi të vetëm dhe për të mos u mohuar ushtrimin e të drejtës së votës zgjedhëse të zonës zgjedhore nr.60, kishte mundësinë të shtynte ditën e votimit, vetëm për proporcionalin në të gjithë vendin në një datë tjetër.

Gjithashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të mos nxirrte rezultatin për subjektet politike në datën 24.6.2001, por të priste përfundimin e raundit të parë për proporcionalin edhe për zonën zgjedhore nr.60, duke eliminuar deformimin e sistemit zgjedhor.

Për më tepër, përsëritja e proporcionalit edhe pas datës 8.7.2001 solli shmangie nga sistemi zgjedhor dhe vjen hapur në kundërshtim me frymën e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Për sa sipër, mendoj se është shkelur parimi i njëkohësisë, si një parim bazë i zhvillimit të zgjedhjeve për subjektet politike në një raund të vetëm.

Duke pasur parasysh Protokollin nr.1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në jurispridencën e saj shpreh për rëndësinë e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Sipas saj, kushtet që rrethojnë këto të drejta duhet të mos cenojnë thelbin e tyre dhe mjetet e përdorura për realizimin e tyre të mos jenë të pabarabarta. Vota e gjithsecilit të ketë peshë të barabartë përsa i përket rezultatit dhe çdo zgjedhës mundësi të barabarata, e drejtë kjo që rrjedh nga e drejta e votës në përgjithësi. Zgjedhjet për subjektet politike në zonën zgjedhore nr.60, janë rrjedhojë e cenimit të barazisë së votuesve, sepse vota e një votuesi të zonës zgjedhore nr.60 ishte më e dobishme se vota e një votuesi në një zonë tjetër zgjedhore, duke ndikuar ndjeshëm në rezultatin përfundimtar të përfaqësimit proporcional, gjë e cila vjen në kundërshtim me nenin 45/4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

E drejta e votës është një e drejtë themelore, sepse nënkupton peshë të barabartë për çdo votë dhe trajtim të barabartë për çdo votues dhe se asnjë mjet ose marrëveshje arbitrare e mëvonshme nuk mund të vlerësojë votën e një votuesi mbi atë të një tjetri.

Fakti që zgjedhësve të zonës zgjedhëse nr.60 iu dha një fuqi vote më e madhe se zgjedhësve të tjerë cenon edhe parimin e shprehjes me besnikëri të vullnetit të popullit, parim i cili lidhet ngushtë me përfaqësimin e popullit në Kuvend.

Megjithatë, mendoj se për të arritur në konkluzionin që zgjedhjet në këtë zonë janë të pavlefshme, duhet parë nëse parregullsitë janë të një shkalle të tillë që të kenë cenuar lirinë, barazinë

ose singëritetin e votimit, duke pasur një ndikim përcaktues në rezultatin përfundimtar.

Në rastin konkret, duke u nisur nga vendimi nr.211, datë 31.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku shpallet rezultati përfundimtar për subjektet politike për zonën zgjedhore nr.60, lehtësisht arrihet në konkluzionin se parregullsitë në zgjedhjet për proporcionalin në këtë zonë ndikojnë ndjeshëm në rezultatin përfundimtar për subjektet politike në të gjithë vendin.

Partia Agrare, që nuk arriti të kalojë pragun e 2.5% të parashikuar në nenin 64/3 të Kushtetutës, për t'u kualifikuar në 24.6.2001 në zonën zgjedhore nr.60 mori 32.7%. Po kështu, Partia Aleanca Demokratike 15.13% dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 10.93%. Ndërsa, dy partitë kryesore morën përkatësisht: Partia Socialiste 5.92% dhe koalicioni "Bashkimi për Fitore" 19.25%.

Pra, rezultatet e mësipërme tregojnë ndikimin e zonës zgjedhore nr.60 në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për subjektet politike në të gjithë vendin.

Për sa sipër, mendoj se kërkesa për shfuqizimin e vendimit nr.211, datë 31.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe për pavlefshmëri të zgjedhjeve për subjektet politike në Zonën Zgjedhore nr.60 është e drejtë dhe duhet pranuar.

ANËTARE

T.Zaka